




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. 03-02/3679/17 Prot. No.
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date 08-11-2017
Përshtime	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.11.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2437-17, për Zyrtarin e lartë z. But Dedaj – Dekan i Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Hasan Prishtina” të Prishtinës, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me Nr. AKK-03-02-2437/17, për Zyrtarin e lartë, z. But Dedaj, Dekan i Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Hasan Prishtina” të Prishtinës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit ka bërë shkresë njoftuese zyrtare së lartë z. But Dedaj (DPK-03-02-2977/17), dhe pastaj ai është kontaktuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, me ç'rast në bisedë zyrtare është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtari i lartë, z. Dedaj është deklaruar se brenda afatit të caktuar nga Agjencia, do të bëjë ndryshimet e nevojshme, dhe do të sjell informacionet në Agjenci.

Ndërkohë, z. Dedaj, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar informacionet mbi ndryshimet në biznesin N.Sh. Innovation Consulting” (DPK/Dpki-03-02/3655/17) të bëra në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilin shihet se, z. But Dedaj tashmë ka hequr



dorë nga funksioni menaxhues në këtë biznes privat, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havolli /

